

Përmbushja e zotimeve zgjedhore të kryetarëve të komunave

Dhjetor, 2024





**PËRMBUSHJA E
ZOTIMEVE ZGJEDHORE
TË KRYETARËVE TË
KOMUNAVE**



Visit our website
www.dplus.org

Zbuloni më shumë për publikimin tonë të fundit,
lajmet, infografikat online.



Na gjeni në Facebook
[@democracyplus](https://www.facebook.com/democracyplus)



Na gjeni në LinkedIn
[@democracy-plus](https://www.linkedin.com/company/democracy-plus)



Na gjeni në Twitter
[@democracy_plus](https://twitter.com/democracy_plus)



Na gjeni në Youtube
[@Democracy.Plus](https://www.youtube.com/Democracy.Plus)

Zyrat tona:

Rruga Bajram Kelmendi, Nr.92, Kati V
Prishtinë, 10000
Kosovë

+383 (0) 38 749 288
info@dplus.org

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet ose transmetohet në çfarëdo forme ose me ndonjë mjet elektronik, mekanik, fotokopjues ose tjera, pa lejen e D+.

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center (OPC). Opinionet dhe të gjeturat e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e organizatave zbatuese të projektit dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.



**OLOF PALMES
INTERNATIONELLA
CENTER**

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje.....	6
2. Metodologjia.....	7
3. Përmbushja e zotimeve zgjedhore të kryetarëve të komunave.....	8
Përmbushja e zotimeve në komuna	13
Komuna e Prizrenit	14
Komuna e Istogut.....	19
Komuna e Graçanicës	21
Komuna e Kamenicës.....	24
Komuna e Lipjanit.....	28
Komuna e Pejës.....	33
Komuna e Mitrovicës së Jugut.....	37
Komuna e Obiliqit.....	42
Komuna e Skënderajt.....	47

1. Hyrje

Në një sistem demokratik, zgjedhjet nuk përfaqësojnë vetëm një akt formal të votimit, por edhe një kontratë mes politikanëve dhe qytetarëve, e bazuar në zotime konkrete për të adresuar nevojat dhe prioritetet lokale. Kryetarët e komunave, si figura kyçe të qeverisjes lokale, shpesh paraqesin plane dhe projekte ambicioze gjatë fushatave zgjedhore, duke premtuar zhvillim ekonomik, përmirësim të shërbimeve publike dhe fuqizim të transparencës. Megjithatë, rëndësia e këtyre zotimeve nuk përfundon me fushatën; ajo shtrihet në realizimin e tyre pas marrjes së detyrës.

Zbatimi i zotimeve zgjedhore është një shtyllë themelore për ndërtimin e besimit midis qytetarëve dhe institucioneve. Ai siguron që pushteti lokal të veprojë sipas nevojave dhe pritshmërive të komunitetit, duke përforcuar llogaridhënien dhe transparencën. Për më tepër, përmbushja e premtimeve zgjedhore lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin

lokal, pasi projektet dhe politikat që zbatohen ndikojnë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Prandaj, analiza e nivelit të përmbushjes së këtyre zotimeve është një hap i domosdoshëm për të vlerësuar efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e qeverisjes lokale.

Për të ndihmuar në vlerësimin e progresit të zotimeve zgjedhore, organizatat jo-qeveritare kanë monitoruar përmbushjen e zotimeve të nëntë kryetarëve të komunave në Kosovë. Në zgjedhjet për kryetarë komunash të vitit 2021, këta kryetarë u zotuan për realizimin e 201 premtimeve zgjedhore, të cilat synuan përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe zhvillimin e komuniteteve të tyre përkatëse.

Rezultatet e monitorimit tregojnë se deri në vitin e fundit të mandatit katërvjeçar (2021-2025), vetëm 37% e zotimeve janë përmbushur plotësisht, ndërsa 47% janë ende në proces zbatimi. Ndërkohë, 16% e zotimeve nuk kanë shënuar asnjë

progres, duke ngritur shqetësime mbi qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e përmbushjes së premtimeve. Sa i përket prioriteteve sipas sektorëve, çështjet sociale, infrastruktura dhe administrata janë trajtuar me përparësi, por ende mbeten sfida të konsiderueshme për të arritur rezultate të plota. Ndërsa sektorët si ekonomia, urbanizmi dhe bujqësia tregojnë mangësi serioze në përmbushjen e zotimeve, duke reflektuar nevojën për fokus të shtuar deri në përfundim të mandatit.

Ky punim synon të shqyrtojë progresin dhe sfidat që kanë hasur këto komuna në përmbushjen e zotimeve zgjedhore, duke vlerësuar ndikimin e tyre në jetën e qytetarëve dhe në funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Analiza gjithashtu synon të nxjerrë mësim për një qasje më të mirë për realizimin e premtimeve, duke forcuar lidhjen mes qytetarëve dhe pushtetit lokal.

2. Metodologjia

Monitorimi i përmbushjes së zotimeve zgjedhore të kryetarëve të komunave është një iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, të cilat veprojnë në kuadër të koalicionit “Aleanca për Qytetari Aktive”. Ky proces koordinohet nga Demokraci Plus (D+), me synim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në nivelin lokal. Gjatë fushatës zgjedhore për kryetarë komunash në vitin 2021, në nëntë komuna të Kosovës u organizuan 27 tubime me qytetarët, nga tri për secilën komunë, duke u fokusuar në identifikimin e kërkesave dhe prioriteteve të tyre ndaj kandidatëve për kryetarë komunash.

Pas përfundimit të takimeve, të gjitha kërkesat e identifikuar nga qytetarët u mbledhën dhe u regjistruan në një bazë të dhënash. Kërkesat u renditën në bazë të numrit të votave të marra gjatë diskutimeve, duke ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve kryesore të qytetarëve.

Për secilën komunë është hartuar një dokument i veçantë, i quajtur “Karta e Zotimeve”. Ky dokument përmban një listë të plotë të kërkesave të qytetarëve, të renditura sipas prioriteteve dhe fushave përkatëse. “Karta e Zotimeve” është konceptuar për t’u prezantuar kandidatëve për kryetarë komune, duke u ofruar atyre mundësinë që ta nënshkruajnë si një formë të kontratës sociale mes tyre dhe qytetarëve që synojnë të qeverisin gjatë mandatit katërvjeçar. Një-

kohësisht, kjo Kartë shërbeu si një mjet i rëndësishëm për shoqërinë civile, duke u përdorur si bazë për monitorimin e qeverisjes lokale në këto nëntë komuna gjatë këtij mandati.

Pas përfundimit të zgjedhjeve, organizatat anëtare të koalicionit “Aleanca për Qytetari Aktive” kanë zhvilluar takime me kryetarët e zgjedhur të komunave për t’u rikujtuar atyre zotimet zgjedhore dhe për të avokuar për përmbushjen e këtyre premtimeve. Progresi në përmbushjen e zotimeve është monitoruar rregullisht nga këto organizata dhe rezultatet e monitorimit po prezantohen në platformën online “zotimet.forumi.online”. Kjo platformë ofron mundësinë për qytetarët që të ndjekin në kohë reale përmbushjen e zotimeve të bëra nga kryetarët e komunave.

Ky projekt është mbështetur nga Olof Palme International Center, ku janë përfshirë nëntë komuna: Graçanicë, Istog, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Pejë, Prizren dhe Skënderaj.

Monitorimi i përmbushjes së zotimeve është realizuar nga organizatat partnere si vijon:

- **Syri i Vizionit:** Pejë, Istog, dhe Skënderaj.
- **EC Ma Ndryshe:** Prizren, Mitrovicë e Jugut, dhe Obiliq.
- **Communication For Social Development:** Graçanicë, Kamenicë, dhe Lipjan.

Ky proces ofron një model të integruar të përfshirjes së qytetarëve, avokimit dhe monitorimit, duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet komunale.

3. Përmbushja e zotimeve zgjedhore të kryetarëve të komunave

Në vitin e fundit të mandatit, janë përmbushur 74 zotime (37%), 95 të tjera janë në proces të zbatimit (47%) që përbën gati gjysmën e tyre, si dhe për 32 të tjera (16%) nuk ka fare progres.

Zotimin për përmbushjen e kërkesave të qytetarëve të bëra gjatë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve për kryetar të komunës 2021, e kanë dhënë nëntë kryetarë të komunave: Shaqir Totaj në Prizren, Ilir Ferati në Istog, Ljiljana Subariq në Graçanicë, Kadri Rahimaj në Kamenicë, Imri Ahmeti në Lipjan, Gazmend Muhaxheri në Pejë, Bedri Hamza në Mitrovicë të Jugut, Xhafer Gashi në Obiliq, dhe Fadil

Nura në Skënderaj. Në përgjithësi nga këta kryetarë të komunave janë bërë 201 zotime zgjedhore ndaj qytetarëve, të cilat duhet të përmbushen përgjatë mandatit të tyre katër vjeçar (2021-2025). Në vitin e fundit të mandatit, janë përmbushur 74 zotime (37%), 95 të tjera janë në proces të zbatimit (47%) që përbën gati gjysmën e tyre, si dhe për 32 të tjera (16%) nuk ka fare progres.



✓ Përbushur

37% (74)

! Pjesërisht


47% (95)


⊘ Nuk ka progres

16% (32)

Nr.	Komuna	Kryetari/ja	Gjithsej zotime	Përbushur ✓	Pjesërisht !	Nuk ka progres ⊘	% të përbushura
1	Lipjan	Imri Ahmeti	25	19	4	2	76%
5	Pejë	Gazmend Muhaxheri	14	8	6	0	57%
6	Skënderaj	Fadil Nura	19	8	10	1	42%
2	Istog	Ilir Ferati	5	2	2	1	40%
3	Obiliq	Xhaferi Gashi	28	15	9	4	39%
4	Graçanicë	Ljiljana Subariq	28	11	13	4	39%
7	Kamenicë	Kadri Rahimaj	21	5	14	2	24%
8	Mitrovicë e Jugut	Bedri Hamza	33	5	20	8	15%
9	Prizren	Shaqir Totaj	28	1	17	10	4%

Statusi i përbushjes së zotimeve sipas fushave



 Nuk ka progres

 Pjesërisht

 Përbushur

Fushat me më shumë zotime të përmbushura janë: Sociale me 23 zotime të përmbushura nga 57 gjithsej, kjo fushë ka përparimin më të lartë. Gjithsesi, 9 zotime nuk kanë progres, ndërsa 25 janë pjesërisht të përmbushura. Në fushën e infrastrukturë me 11 zotime të përmbushura nga gjithsej 34, kjo fushë mbetet në mesin e fushave me performancë të moderuar. Ndërsa në fushën e administratë janë përmbushur 10 zotime, por ende 3 zotime nuk kanë progres dhe 15 janë pjesërisht të përmbushura.

Fushat me progres të kufizuar: Ambient me vetëm 7 zotime të përmbushura dhe 9 pjesërisht, ndërsa 4 nuk kanë progres. Fushat e Urbanizmit dhe bujqësisë tregojnë mungesë të theksuar përparimi, me asnjë zotim të përmbushur dhe shumicën në fazën e pjesërisht ose pa progres. Në fushën e ekonomisë gjendja është më kritike, pasi asnjë zotim nuk është përmbushur plotësisht, vetëm një është pjesërisht i përmbushur.

Fushat me rezultate të përziera janë: Inspektorat që ka 10 zotime pjesërisht të përmbushura dhe 3 të realizuara plotësisht, por pa zotime pa progres. Arsimit me 5 zotime të përmbushura nga 12, kjo fushë ka përparim të moderuar. Ndërsa fushat e sigurisë dhe kulturës edhe pse kanë zotime të pakta, disa janë përmbushur plotësisht (3 secila), ndërsa të tjerat mbeten pa progres.

Fushat me zotime të izoluara dhe progres minimal janë: Transport dhe sport që kanë vetëm 2 përkatësisht 1 zotime të përmbushura. Ndërsa shërbime publike dhe turizëm tregojnë progres të vogël, me përmbushje të pjesshme dhe vetëm disa zotime të realizuara.




Përmbushja e zotimeve në komuna



Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunë së Prizrenit gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2021, ishte zotuar për adresimin e 28 problemeve të komunës në shtatë (7) fusha.



✓ Përbushur

! Pjesërisht

✗ Nuk ka progres

37% (74)

47% (95)

16% (32)

Sipas gjetjeve nga monitorimi, në këtë komunë nga dhjetë zotimet në çështjet sociale, vetëm një (1): çështja e problemit të qeneve endacak është zgjidhur, që do të thotë se kryesisht problemet sociale që janë identifikuar nuk janë adresuar në mënyrë të plotë. Megjithatë, disa nga këto zotime kanë pasur progres të pjesërisht, siç është rritja e inspektimeve për respektimin e të drejtave të punëtorëve dhe ofrimi i qasjes për lëvizje të lirë për personat me aftësi të kufizuara. Kjo tregon një nevojë të madhe për angazhim të mëtejshëm dhe mund të jetë një tregues i sfidave në menaxhimin e problemeve sociale.

Sa i përket infrastrukturës, katër (4) nga gjashtë (6) zotimet janë realizuar pjesërisht. Kryesisht janë ndërmarrë hapa për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, furnizimin me ujë të pijshëm, rregullimin e ndriçimit publik, mirëpo disa projekte, si funksionalizimi i semaforëve dhe krijimi i tregut dhe parkut në lagjen Dardania, nuk kanë pasur progres.

Në fushën e administratës, asnjë zotim nuk është përmbushur plotësisht, dy (2) janë realizuar pjesërisht, ndërsa një (1) është ende pa progres. Progresi i pjesshëm është arritur në disa aspekt, si në eliminimin e burokracisë dhe digjitalizimin e shërbimeve komunale për qytetarë. Por, në pritje është ende hartimi i plan strategjik për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Edhe në fushën e urbanizmit janë dhënë tri (3) zotime, asnjë prej tyre nuk ka shënuar progres të plotë. Përparim i pjesshëm është arritur në zgjidhjen e problemeve të trafikut të dendur dhe emërimin e rrugëve, ndërsa zotimi për hartimin e planit të mobilitetit për zonën e parë historike nuk ka shfaqur progres.

Inspektoriati është fusha e cila ka shënuar përmbushje të pjesshme të zotimeve nga ana e komunës. Këtu përfshihen mbrojtja dhe kontrollimi i zonave historike, ndalimi i shfrytëzimit të trotuareve si parkingje të veturave dhe ndalimi i dëmtimit të shtratit të lumit nga intervenimet me mjete të rënda. Edhe në shërbime publike, janë realizuar pjesërisht zotimet, ku bëjnë pjesë mirëmbajtja dhe shtimi i hapësirave të gjelbra dhe hartimi i planit për menaxhimin e mbeturinave.

Ndërsa në fushën e turizmit, që ka qenë vetëm një (1) zotim nuk është përmbushur, ai për formimin e hapësirës për promovim të shitjes së punëve artizanale.






Sociale 10

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Zgjidhja e problemit të qeneve endacak	Përbushur
2	Ofrimi i qasjes për lëvizje të lirë në rrugë për personat me aftësi të kufizuara	Pjesërisht
3	Organizimi i aktiviteteve për edukimin e të rinjve	Pjesërisht
4	Rritja e inspektimeve për respektimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat dhe publik	Pjesërisht
5	Subvencionimi i bizneseve që aftësojnë dhe punësojnë të rinj	Pjesërisht
6	Hartimi i Planit Strategjik për Aftësimin e të Rinjve	Nuk ka progres
7	Hartimi i Rregullores për Vullnetarizëm	Nuk ka progres
8	Garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të punës të komuniteteve joshumicë	Nuk ka progres
9	Krijimi i Qendrës profesionale për orientim në karrierë	Nuk ka progres
10	Zhvillimi i kampanjave për vetëdijësimin e qytetarëve për të drejtat e punës	Nuk ka progres




Infrastrukturë **6**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm	 Pjesërisht
2	Ofrimi i ndriçimit publik	 Pjesërisht
3	Rregullimi i ndriçimit publik nëpër lagje	 Pjesërisht
4	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore	 Pjesërisht
5	Funksionalizimi i semaforëve	 Nuk ka progres
6	Krijimi i tregut dhe parkut në Lagjen Dardania	 Nuk ka progres

Administratë **3**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Eliminimi i burokracisë në komunë	 Pjesërisht
2	Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarë	 Pjesërisht
3	Hartimi i Planit strategjik për menaxhimin e burimeve njerëzore	 Nuk ka progres

Inspektorat **3**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ndalimi i shfrytëzimit të trotuareve si parkingje të veturave	 Pjesërisht
2	Ndalimi i dëmtimit të shtratit të lumit nga intervenimet me mjete të rënda	 Pjesërisht
3	Mbrojtja dhe kontrollimi i zonave historike	 Pjesërisht



Urbanizëm 3

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Emërimet e të gjitha rrugëve	Pjesërisht
2	Zgjidhja e problemit të trafikut të dendur	Pjesërisht
3	Hartimi i planit të mobilitetit për zonën e parë historike	Nuk ka progres



Shërbime Publike 2

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Hartimi i Planit për menaxhimin e mbeturinave	Pjesërisht
2	Mirëmbajtja dhe shtimi i hapësirave të reja të gjelbra	Pjesërisht



Turizëm 1

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Krijimi i hapësirës për promovim të shitjes së punëve artizanale	Nuk ka progres



Komuna e Istogut

Kryetari i Komunë së Istogut gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2021, ishte zotuar për adresimin e pesë (5) problemeve të komunës në katër (4) fusha



✓ Përbushur

40%

! Pjesërisht



40%

✗ Nuk ka progres


20%

Të dhënat e tabelës tregojnë se nga pesë (5) zotimet e dhëna, dy (2) prej tyre janë përmbushur plotësisht. Në fushën e administratës është realizuar zotimi për depolitizimin e proceseve të punësimit, ndërsa në fushën e turizmit është përmbushur zotimi për zhvillimin e turizmit malor. Përparim i pjesshëm është arritur në ndërtimin e kopshteve ditore për fëmijë, që lidhet me fushën sociale, si dhe në ndërtimin e kanaleve të ujitjes për tokat bujqësore në fushën e bujqësisë. Ndërsa, zotimi tjetër për furnizimin me llaktofriz dhe makina mbjellëse për fermat e lopëve, nuk ka shënuar progres.


Bujqësi 2

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes për tokat bujqësore	 Pjesërisht
2	Furnizimi me llaktofriz dhe makina mbjellëse për fermat e lopëve	 Nuk ka progres

Turizëm 1

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Zhvillimi i turizmit malor	 Përmbushur

Administratë 1

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Depolitizim të proceseve të punësimit	 Përmbushur

Sociale 1

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ndërtimi i kopshteve ditore për fëmijë	 Pjesërisht



Komuna e Graçanicës

Kryetarja e Komunë së Graçanicës gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2021, ishte zotuar për adresimin e 19 problemeve të komunës në katër (4) fusha.



✓ Përbushur

39%

! Pjesërisht

46%

✗ Nuk ka progres

15%

Sipas të këtyre të gjeturave, në fushën e ambientit, nga shtatë (7) zotime, tre (3) prej tyre janë përmbushur plotësisht, përfshirë pastrimin e lumenjve dhe largimin e deponive ilegale në fshatrat Shushicë dhe Dobratin. Megjithatë, tre (3) zotime të tjera, si zgjidhja e ndotjes së lumit Graçanka, largimi i deponive ilegale në fshatin Proece dhe rehabilitimi i kanalit në Gushtericë të Poshtme, kanë shënuar progres të pjesshëm. Zotimi për zgjidhjen e problemit me llumin mbetet ende pa asnjë progres.








Në fushën e administratës, nga pesë (5) zotime, vetëm një (1) është përmbushur plotësisht, që ka të bëjë me përkufizimin e qartë të roleve, detyrimeve dhe të drejtave në kontratat e punës. Ndërkohë, progres i pjesshëm është shënuar në përmirësimin e komunikimit mes vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve qendrore, si dhe në rritjen e funksionalitetit të departamentit të zhvillimit ekonomik dhe Kuvendit Komunal. Gjithashtu, është shënuar progres i pjesshëm në zvogëlimin e ndikimit politik tek punëtorët.

Në fushën sociale, katër (4) zotime janë dhënë por asnjëri nuk është realizuar plotësisht. Të gjitha zotimet, përfshirë krijimin e hartës sociale, zvogëlimi i ndikimit politik tek të rinjtë dhe rritjen e punësimit për grupet e marginalizuara, kanë shënuar vetëm progres të pjesshëm.






Në fushën e infrastrukturës, nga tre (3) zotime, vetëm një (1) është përmbushur plotësisht, që është rregullimi i kanalizimit në fshatin Dobratin. Progres i pjesshëm është arritur në furnizimin me ujë në Shushicë dhe rregullimin e rrugëve e trotuareve në territorin e komunës.

Në përgjithësi, pavarësisht disa përmbushjeve të plotë, një pjesë e madhe e zotimeve mbeten në fazën e realizimit të pjesshëm ose pa progres të dukshëm.


Ambient **7**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Pastrimi i lumit dhe largimi i deponive ilegale në fshatin Shushicë, si dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra	 Përmbushur
2	Pastrimi i lumit dhe shtratit të lumit në fshatin Dobratin	 Përmbushur
3	Largimi i deponive ilegale në fshatin Dobratin	 Përmbushur
4	Zgjidhja e çështjes së ndotjes së lumit Graçanka	 Pjesërisht
5	Pastrimi i lumit dhe shtratit të lumit, si dhe largimi i deponive ilegale në fshatin Proece	 Pjesërisht
6	Rehabilitimi i kanalit të lumit për shkak të përmytjeve në fshatin Gushtericë e Poshtme	 Pjesërisht
7	Zgjidhja e problemit me llumin	 Nuk ka progres




Administratë 5

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Përkufizimi i qartë i roleve, detyrimeve dhe të drejtave në kontratat e punës	 Përbushur
2	Përmirësimi i komunikimit midis vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve qendrore	 Pjesërisht
3	Përmirësimi i funksionalitetit të departamentit për zhvillimin ekonomik, si dhe zhvillimi i pabarabartë	 Pjesërisht
4	Përmirësimi i funksionalitetit të Kuvendit Komunal	 Pjesërisht
5	Zvogëlimi i ndikimit politik tek punëtorët	 Pjesërisht

Sociale 4

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Krijimi i hartës sociale të popullsisë	 Pjesërisht
2	Zvogëlimi i ndikimit politik tek të rinjtë	 Pjesërisht
3	Ndryshimi i qasjes së të rinjve me qëllim të krijimit të besimit në institucione	 Pjesërisht
4	Rritja e numrit të punëtorëve nga grupi i personave të marginalizuar	 Pjesërisht

Infrastrukturë 3

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Rregullimi i kanalizimit në fshatin Dobratin	 Përbushur
2	Zgjidhja e çështjes së furnizimit me ujë në fshatin Shushicë	 Pjesërisht
3	Rregullimi i rrugëve dhe trotuareve në territorin e të gjithë komunës	 Pjesërisht

Në Komunën e Kamenicës, fusha e administratës ka gjithsej tetë (8) zotime, prej të cilave dy (2) janë përbushur



Komuna e Kamenicës

Kryetari i Komunë së Kamenicës gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2021, ishte zotuar për adresimin e 21 problemeve të komunës në shatë (7) fusha.



✓ Përbushur

24%

! Pjesërisht

67%

✗ Nuk ka progres

9%

plotësisht, si digjitalizimi i shërbimeve komunale dhe zbatimi i Ligjit të Punës në nivel komunal. Progres i pjesshëm është shënuar në disa aspekte, si rritja e kompetencave të bashkësive lokale, funksionalizimi i zyrës për këshillat lokale, dhe mbajtja e takimeve mujore mes kryetarit të komunës dhe këshillave lokale. Megjithatë, avokimi në nivel qendror për të angazhuar noter në komunë mbetet pa progres.









Në fushën sociale, nga shtatë (7) zotime, vetëm dy (2) janë përmbushur: hartimi i strategjisë për rritjen e punësimit të grave dhe eliminimi i diskriminimit në punësim për personat me aftësi të kufizuara. Pjesërisht është arritur përfshirja më e madhe e grave në komisione vendimmarrëse të komunës dhe, nxitja e tyre për të udhëhequr këshillat lokale, si dhe hartimi i strategjisë për uljen e emigrimit të të rinjve, e të ngjashme.

Inspektorati kishte dy (2) zotime, nga të cilat është zbatuar rregullorja kundër ndotjes akustike, ndërsa rritja e kapaciteteve të komunës për inspektim të punës mbetet në progres të pjesshëm.

Në infrastrukturë dhe arsim, progresi është i kufizuar. Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe orientimi i shkollave profesionale drejt nevojave të tregut të punës janë vetëm pjesërisht të përmbushura.

Në ambient, zotimi për trajtimin e mbeturinave të ngurta nuk ka shënuar fare progres, ndërsa në fushën e sigurisë, rritja e investimeve në brezin kufitar, me fokus në Karaçevë, mbetet në progres të pjesshëm.

Administratë **8**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Avokimi në nivel qendror për të angazhuar Noter në komunë	 Nuk ka progres
2	Rritja e kompetencave të bashkësive lokale	 Pjesërisht
3	Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarët	 Përmbushur
4	Rritja e përgjegjësisë së drejtuesve të Këshillat Lokale	 Pjesërisht
5	Funksionalizimi i një zyre për nevojat e këshillave	 Pjesërisht
6	Rritja e bashkëpunimi në mes të organeve komunale dhe këshillave lokale	 Pjesërisht
7	Mbajtja e takimeve mujore në mes të kryetarit të komunës dhe udhëheqësve të këshillave lokale	 Pjesërisht
8	Zbatimi i Ligjit të Punës në nivel komunal	 Përmbushur



Sociale 7

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Krijimi i hartës sociale të popullsisë	! Pjesërisht
2	Zvogëlimi i ndikimit politik tek të rinjtë	! Pjesërisht
3	Ndryshimi i qasjes së të rinjve me qëllim të krijimit të besimit në institucione	✓ Përbushur
4	Rritja e numrit të punëtorëve nga grupi i personave të marginalizuar	! Pjesërisht
5	Rritja e numrit të punëtorëve nga grupi i personave të marginalizuar	! Pjesërisht
6	Rritja e numrit të punëtorëve nga grupi i personave të marginalizuar	! Pjesërisht
7	Rritja e numrit të punëtorëve nga grupi i personave të marginalizuar	✓ Përbushur



Inspektorat 2

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Zbatimi i Rregullores kundër ndotjes akustike	✓ Përbushur
2	Rritja e kapaciteteve të komunës për inspektim të punës	! Pjesërisht




Infrastrukturë 1

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm	! Pjesërisht


Ambient **1**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Trajtimi i mbeturinave të ngurta	 Nuk ka progres

Arsim **1**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Orientimi i shkollave profesionale në drejtim të ndërlidhjes me nevojat e tregut të punës	 Pjesërisht


Siguri **1**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Rritje të investimeve në brezin kufitar, në fokus Karaçeva	 Pjesërisht



Komuna e Lipjanit

Kryetari i Komunë së Lipjanit gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2021, ishte zotuar për adresimin e 26 problemeve të komunës në tetë (8) fusha.



✓ Përbushur

76%

! Pjesërisht

16%

✗ Nuk ka progres

8%

Në këtë komunë, fusha sociale, me 11 zotime, ka shënuar progres të dukshëm, ku nëntë (9) prej tyre janë përmbushur plotësisht. Ndër sukseset kryesore përfshihet hapja e çerdheve të reja në zonat rurale, përkrahja e projekteve individuale, organizimi i aktiviteteve për të rinjtë, ndarja e subvencioneve për organizatat rinore, dhe zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore në punësime. Megjithatë, fillimi i dialogut social në nivel komunal ende nuk ka shënuar progres, ndërsa subvencionimi i pagave për të rinjtë që hyjnë për herë të parë në tregun e punës mbetet në progres të pjesshëm.

Infrastruktura përbën një nga fushat me realizim të plotë, ku të gjitha katër (4) zotimet janë përmbushur, duke përfshirë këtu shtimin e shtigjeve për biçikleta, rregullimin e trotuareve në fshatrat Kraishtë dhe Gadime, funksionalizimin e ujësjellësit dhe asfaltimin e rrugicave. Fusha e ambientit gjithashtu ka shënuar përmbushje të plotë të zotimeve, me formimin e hapësirave të gjelbra në fshatra dhe rregullimin e shtratit të lumenjve.

Në inspektoriat, është arritur formimi i kontakteve mes komunës dhe këshillave të fshatrave për mbikëqyrjen e projekteve, ndërsa avokimi në nivel qendror për rritjen e numrit të inspektorëve të punës mbetet në progres të pjesshëm.

Në arsim, realizuar zotimi për rritjen e numrit të bursave për studentët, ndërsa ndarja e bursave për nxënësit e shkollave të mesme ka shënuar progres të pjesshëm.

Fusha e kulturës përfshinte dy (2) zotime, ndër to është përmbushur rritja e buxhetit për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërsa ndërtimi i shtëpisë së kulturës mbetet në progres të pjesshëm.

Në administratë, është përmbushur zotimi për formimin e një grupi mbikëqyrës të përbërë nga organizata të shoqërisë civile për konkurset publike. Megjithatë, në transport, zotimi për ofrimin e transportit urban gjatë natës, me fokus në zonat rurale, nuk ka shënuar asnjë progres.



Sociale 11



Nr.	Zotimi	Statusi
1	Identifikimi i nevojave të të rinjëve në zonat rurale dhe të punohet në atë fushë	✓ Përbushur
2	Mundësimi i praktikës për nxënës të shkollave të mesme në institucione publike dhe private	✓ Përbushur
3	Përkrahje nga komuna për projekte individuale	✓ Përbushur
4	Organizimi i aktiviteteve për nxitje të aktivizimit të të rinjve	✓ Përbushur
5	Ndarja e subvencioneve për organizatat rinore	✓ Përbushur
6	Zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore në punësime në komunë	✓ Përbushur
7	Hapja e çerdheve të reja në zonat rurale	✓ Përbushur
8	Nisja e dialogut social në nivel komunal	✗ Nuk ka progres
9	Subvencionimi i pagave për të rinjtë dhe të rejtat që hyjnë për herë të parë në tregun e punës	⚠ Pjesërisht
10	Krijimi i programeve për orientim në karrierë	✓ Përbushur
11	Organizimi i kampanjave për siguri dhe shëndet në punë për të rinjtë dhe të rejtat	✓ Përbushur





Infrastrukturë 4

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Më shumë shtigje të biçikletave në qytet	✓ Përbushur
2	Rregullimi i trotuareve në fshatin Kraishtë dhe Gadime	✓ Përbushur
3	Funksionalizimi i ujësjellësit	✓ Përbushur
4	Asfaltimi i rrugicave	✓ Përbushur


Ambient **2**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Krijimi i hapësirave të gjelbra nëpër fshatra	 Përbushur
2	Rregullimi i shtratit të lumenjve	 Përbushur



Inspektorat **2**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Krijimi i kontakteve në mes të komunës dhe këshillave të fshatrave për mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve	 Përbushur
2	Avokimi në nivelin qendror për rritje të numrit të inspektorëve të punës në Lipjan	 Pjesërisht

Arsim **2**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Rritja e numrit të bursave për studentët	 Përbushur
2	Ndarja e bursave për nxënësit e shkollave të mesme	 Pjesërisht

Kulturë **2**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ndërtimi i shtëpisë së kulturës	 Pjesërisht
2	Rritja e buxhetit për Kulturë, Rini dhe Sport	 Përbushur



Administratë 1

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Krijimi i një grupi mbikëqyrës të përbërë nga organizata të shoqërisë civile për konkurset publike	Përbushur



Transport 1

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ofrimi i transportit urban gjatë natës, me fokus në zonat rurale	Nuk ka progres



Komuna e Pejës

Kryetari i Komunë së Pejës gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2021, ishte zotuar për adresimin e 14 problemeve të komunës në tetë (8) fusha.



✓ Përbushur

57%

! Pjesërisht

43%

✗ Nuk ka progres

0%

Nga gjetjet e monitorimit për këtë komunë, në fushën sociale janë dhënë tri (3) zotime ku dy (2) prej tyre janë realizuar plotësisht si: hapja e një kopshti të ri për fëmijë dhe nxitjen e punësimit të rinjve përmes projekteve dhe orientimit në karrierë. Megjithatë, hapja e çerdheve të reja në zonat rurale mbetet në progres të pjesshëm.





Nga katër (4) zotimet në fushën e infrastrukturës (2) janë përmbushur plotësisht, përfshirë rregullimin e kanalit të Shkollës Filllore “Xhemajl Kada” dhe kyçjen e lagjes “7 Shtatori” në rrjetin e kanalizimit. Rregullimi i ujësjellësit në Rugovë dhe sinjalizimi horizontal për çiklistët mbeten në progres.

Turizmi shënon përmbushje të plotë, me të dy (2) zotimet e realizuara, përfshirë formimin e një këndi për suvenire në Muzeun e Qytetit dhe fuqizimin e Zyrës Turistike për promovimin e destinacioneve lokale. Në fushën e administratës, zotimi për digjitalizimin e shërbimeve për qytetarët është përmbushur me sukses, duke lehtësuar qasjen në dokumente dhe aplikime. Ndërsa zotimi për rregullimin e hapësirave publike në lagjen Fidanishte në fushën e ambientit ka shënuar progres të pjesshëm.




Përmbushje e pjesshme e zotimeve është shënuar edhe në fushën e inspektoratit dhe shëndetësisë ku për secilën kaqenë nga një (1) zotim si: largimi i shitësve ilegal të druve dhe kafshëve në inspektoriat dhe hapja e laboratorit për analiza në QKMF në shëndetësi.

Në shërbimet publike, është përmbushur zotimi për rregullimin e rrjetit elektrik në Rugovë, duke sjellë përmirësime në furnizimin me energji për banorët e zonës.



Infrastrukturë 4

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Trajtimi i kanalit të hapur të Shkollës Filllore “Xhemajl Kada”	 Përmbushur
2	Kyçja në kanalizim të qytetit të lagjes 7 Shtatori	 Përmbushur
3	Rregullimi i ujësjellësit në regjionin e Rugovës	 Pjesërisht
4	Sinjalizimi horizontal për çiklistët	 Pjesërisht


Sociale **3**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Hapja e një kopshti të ri për fëmijët	 Përbushur
2	Nxjtja e punësimit të të rinjve përmes projekteve inovative, orientimit të hershëm në karrierë, dhe zhvillimi të shkathtësive të kërkuara në tregun e punës	 Përbushur
3	Hapjen e çerdheve të reja për fëmijët	 Pjesërisht


Turizëm **2**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Krijimi i këndit për shitje të syvenirëve në Muzeun e Qytetit	 Përbushur
2	Fuqizimi i Zyrës Turistike në Pejë	 Përbushur


Administratë **1**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarët	 Përbushur


Ambient **1**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Rregullimi i hapësirave publike të banesat e lagjes Fidanishte	 Pjesërisht


Inspektorat **1**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Largimi i shitësve ilegal të druve dhe kafshëve në lagjen 7 Shtatori	 Pjesërisht

Shëndetësi **1**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Hapja e Laboratorit në QKMF për realizimin e analizave laboratorike të përgjithshme	 Pjesërisht


Shërbime Publike **1**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Rregullimi i rrjetit elektrik në regjionin e Rugovës	 Përbushur



Komuna e Mitrovicës së Jugut

Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2021, ishte zotuar për adresimin e 20 problemeve të komunës në shtatë (7) fusha.



✓ Përbushur

15%

! Pjesërisht

61%

✗ Nuk ka progres

24%

Sipas të dhënave të monitorimit, në fushën sociale janë dhënë shtatë (7) zotime, nga të cilat asnjë nuk është përmbushur plotësisht. Gjashtë (6) zotime janë realizuar pjesërisht, përfshirë rritjen e numrit të çerdheve publike, hartimin e programeve të orientimit në karrierë për të rinjtë, përfshirjen e grave në tregun e punës përmes ndarjes së buxhetit për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, e të ngjashme. Ndërkohë, mbështetja për marketing të qendrave për aftësim profesional dhe shkolla profesionale nuk ka shënuar progres.

Në fushën e ambientit janë dhënë gjashtë (6) zotime, ku vetëm një (1) është përmbushur plotësisht: mirëmbajtja e liqenit akumulues. Tre (3) zotime, përfshirë rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe mbjelljen e fidanëve janë realizuar pjesërisht, ndërsa avancimi i riciklimit dhe aplikimi i gjobave mandatore për hedhjen e mbeturinave nuk kanë shënuar progres.

Fusha e infrastrukturës ka pesë (5) zotime, të cilat janë të realizuara pjesërisht. Këtu përfshihet përmirësimi i infrastrukturës rrugore, menaxhimi i hapësirave publike, dhe rregullimi i sistemit të kanalizimit.

Në administratë janë dhënë tre (3) zotime, ku vetëm një (1) është përmbushur plotësisht: menaxhimi më i mirë i pasurive të komunës dhe krijimi i bazës së të dhënave të pronave. Ndërsa, digjitalizimi i shërbimeve komunale dhe punësimet në bazë të meritës mbeten në progres të pjesshëm.

Tri (3) zotimet e dhëna në fushën e Inspektoriatit, janë të realizuara pjesërisht, përfshirë ndalimin e ndotjes akustike, ndalimin e keqpërdorimit të ujit të pijshëm dhe rritjen e numrit të inspektorëve.








Në fushën e kulturës nga tri (3) zotime, vetëm një (1) është përmbushur plotësisht: rritja e investimeve për zhvillimin e programeve kulturore. Ndërsa ndërtimi i objekteve për Shkollën e Muzikës dhe Muzeun e Qytetit nuk kanë shënuar progres.

Tek shërbimet publike, eliminimi i mbeturinave tek shkolla "Eqrem Qabej" dhe shkolla e Mjekësisë "Dr. Xheladin Deda" ka shënuar progres të pjesshëm ndërsa përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave nuk ka pasur progres.







Nga dy (2) zotime në fushën e sigurisë, trajtimi i qenve endacak dhe krijimi i qendrave për kujdesin e kafshëve është realizuar plotësisht. Ndërsa, vendosja e sinjalizimeve akustike për personat e verbër nuk ka shënuar progres.

Në sport është dhënë një (1) zotim për funksionalizimin e objektit "Omni Sport" dhe ofrimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara, por nuk ka pasur progres në realizim.

Sociale 7

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ofrimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara në objektin e komunës dhe institucionet tjera publike	 Pjesërisht
2	Përfshirja e grave në treg të punës përmes buxhetit për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe rritjes së numrit të çerdheve	 Pjesërisht
3	Rritja e punësimit të rinisë përmes krijimit të programit të orientimit në karrierë	 Pjesërisht
4	Rritja e numrit të çerdheve publike	 Pjesërisht
5	Ndarje të buxhetit për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, me fokus tek gratë ndërmarrëse	 Pjesërisht
6	Ndarja e bursave për studentët nga fushat që kanë më shumë kërkesë në tregun e punës	 Pjesërisht
7	Mbështetja në marketing të qendrave për aftësim profesional dhe shkollat profesionale	 Nuk ka progres




Ambient 6

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Rregullimi i shtretërve të lumenjve	 Pjesërisht
2	Mirëmbajtja e liqenit akumulues	 Përbushur
3	Mbjellja dhe mirëmbajtja e fidanëve	 Pjesërisht
4	Avancimi i riciklimit	 Nuk ka progres
5	Mirëmbajtje e pajisjeve të kompanisë për mirëmbajtje KRM "Uniteti"	 Pjesërisht
6	Aplikimi i gjobave mandatorë për hedhjen e mbeturinave	 Nuk ka progres




Infrastrukturë **5**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Menaxhimi i hapësirave publike	 Pjesërisht
2	Përmirësimi i infrastrukturës rrugore	 Pjesërisht
3	Rritja e numri të parkingjeve dhe ndalimi i parkingut në trotuare	 Pjesërisht
4	Rritja e shtypjes së ujit në ndërtesa kolektive	 Pjesërisht
5	Rregullimi i sistemit të kanalizimit	 Pjesërisht




Administratë **3**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Punësimet në bazë të meritës	 Pjesërisht
2	Menaxhimi më i mirë e pasurive të komunës dhe krijimi i bazës së të dhënave të pronave të komunës	 Përbushur
3	Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarët	 Pjesërisht



Inspektorat **3**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ndalim i ndotjes akustike në qendër	 Pjesërisht
2	Ndalimi i keqpërdorimit të ujit të pijshëm	 Pjesërisht
3	Rritje të numrit të inspektorëve	 Pjesërisht



Kulturë **3**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Rritja e investimeve për zhvillimin e programeve kulturore	 Përbushur
2	Shkolla e Muzikës të ketë objektin e saj	 Nuk ka progres
3	Muzeu i Qytetit të ketë objektin e saj	 Nuk ka progres


Shërbime Publike **2**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Eliminimi i mbeturinave tek shkolla “Eqrem Qabej” dhe Shkolla e Mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”	 Pjesërisht
2	Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave	 Nuk ka progres

Siguri **2**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Vendosja e akustikës në semaforët për sinjalizim të personave të verbër	 Nuk ka progres
2	Trajtimi i qenve endacak në rrugë dhe krijimi i qendrave për kujdesin e kafshëve	 Përbushur

Sport **1**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Funksionalizimi i “Omni Sport” dhe ofrimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara	 Nuk ka progres



Komuna e Obiliqit

Kryetari i Komunë së Obiliqit gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2021, ishte zotuar për adresimin e 28 problemeve të komunës në nëntë (9) fusha.



✓ Përbushur

54%

! Pjesërisht

32%

✗ Nuk ka progres

14%

Sipas gjetjeve të monitorimit, Komuna e Obiliqit, në fushën sociale ka dhënë në total nëntë (9) zotime, nga të cilat gjashtë (6) janë përmbushur plotësisht. Këtu përfshihen nxitja e qytetarëve për të marrë pjesë në dëgjimet buxhetore, organizimi i takimeve mes komunës dhe përfaqësuesve të fshatrave, rritja e punësimit të grave, buxheti i përgjegjshëm gjinor, ofrimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara në fshatin Lajthishtë dhe Hamidi dhe rritja e numrit të projekteve për rini. Ndërsa, përmirësimi i infrastrukturës për personat me nevoja të veçanta ka pasur progres të pjeshëm, në anën tjetër, dy (2) zotime tjera mbeten pa progres, përfshirë promovimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat dhe rritjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Në fushën e infrastrukturës, nga shtatë (7) zotime të dhëna, prej tyre tre (3) janë përmbushur plotësisht, përfshirë këtu rregullimin e kanalizimit në rrugën "Idriz Sallova", riparimin e rrugës Hamidi-Siboc, dhe rregullimin e trajtimit të ujërave të zeza në fshatin Breznicë dhe katër lagje të tjera. Dy (2) zotime tjera janë realizuar pjesërisht, përfshirë furnizimin me ngrohje qendrore dhe zgjerimin e rrugëve nëpër lagjet e qytetit. Ndërsa, shtrimi i trotuarit dhe rregullimi i fushës së sportit në fshatin Lajthishtë, si dhe shtrimi i trotuarit në rrugën Breznic-Kozaricë, nuk kanë pasur progres.

Në fushën e administratës, janë dhënë katër (4) zotime, nga të cilat dy (2) janë përmbushur plotësisht. Këtu përfshihet zbatimi i Ligjit për Obiliqin dhe rritja e punësimit të ekspertëve të rinj, me fokus në sektorin e mbrojtjes së mjedisit. Dy zotime të tjera siç janë qartësimi i statusit për regjistrimin e pronave në fshatin Lajthishtë dhe digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarët, janë realizuar pjesërisht.

Në fushën e shëndetësisë, dy (2) zotimet e dhëna janë përmbushur plotësisht: furnizimi me pajisje mbrojtëse në QKMF dhe pagesa për vullnetarët e Kryqit të Kuq.

Në fushën e arsim, janë dhënë dy (2) zotime, nga të cilat një (1) është përmbushur plotësisht, që ka pasur të bëjë me orët e mësimdhënësve të jenë të plota dhe ndarja të jetë meritore. Ndërsa zotimi tjetër që synonte përfshirjen e psikologëve në shkolla, është realizuar pjesërisht.

Fusha e bujqësisë, ekonomisë, dhe inspektoriatit ka pasur nga një (1) zotim, të cilat janë përmbushur pjesërisht, këtu përfshihej: rritja e investimeve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, rritja e bashkëpunimit të komunës me bizneset për të inkurajuar ofrimin e programeve të praktikës me pagesë si dhe zbatimi i kontratave të punës dhe respektimi i Ligjit të Punës për punëtorët në sektorin privat

Në transport, është dhënë një (1) zotim për ofrimin e transportit publik nëpër fshatra, i cili është përmbushur plotësisht.



Sociale 9





Nr.	Zotimi	Statusi
1	Përmirësimi i infrastrukturës për personat me nevoja të veçanta	⚠ Pjesërisht
2	Ofrimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara në fshatin Lajthishtë dhe Hamidi	✅ Përbushur
3	Nxitja e qytetarëve për të marrë pjesë në dëgjimet buxhetore	✅ Përbushur
4	Organizimi i takimeve në mes të komunës dhe përfaqësuesve të fshatrave	✅ Përbushur
5	Rritja e numrit të projekteve për rini	✅ Përbushur
6	Promovimi i të drejtave të punëtorëve në sektorin privat	❌ Nuk ka progres
7	Rritja e punësimit të grave	✅ Përbushur
8	Buxhetim të përgjegjshëm gjinor	✅ Përbushur
9	Rritja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara	❌ Nuk ka progres





Infrastrukturë 7

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Rregullimi i kanalizimit në rrugën "Idriz Sallova"	✅ Përbushur
2	Furnizimi me ngrohje qendrore	⚠ Pjesërisht
3	Riparimi i rrugës Hamidi-Siboc	✅ Përbushur
4	Zgjerimi i rrugëve nëpër lagjet e qytetit	⚠ Pjesërisht
5	Shtrimi i trotuarit dhe rregullimi i fushës së sportit në fshatin Lajthishtë	❌ Nuk ka progres
6	Shtrimi i trotuarit në rrugën Brezhnic-Kozaricë	❌ Nuk ka progres
7	Rregullimi i trajtimit të ujërave të zeza – kanalizimit në 4 lagje të fshatit Breznicë, Lagja Kosokovik, Perveticë dhe Sylja	✅ Përbushur



Administratë **4**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Zbatimi i Ligjit për Obiliqin	 Përbushur
2	Qartësim i statusit për regjistrim të pronave në fshatin Lajthishtë	 Pjesërisht
3	Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarë	 Pjesërisht
4	Rritja e punësimit të ekspertëve të rinj, me fokus në sektorin e mbrojtjes së mjedisit	 Përbushur


Shëndetësi **2**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Furnizimi me pajisje mbrojtëse në QKMF	 Përbushur
2	Pagesa të vullnetarët e Kryqit të Kuq	 Përbushur

Arsimit **2**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Orët e mësimdhënësve të jenë të plota dhe të ketë ndarje meritore	 Përbushur
2	Përfshirja e psikologëve në shkolla	 Pjesërisht


Bujqësi 1

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Rritja e investimeve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë	 Pjesërisht


Transport 1

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ofrimi i transportit publik nëpër fshatra	 Përbushur

Ekonomi 1

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Rritja e bashkëpunimit të komunës me bizneset për të inkurajuar ofrimin e programeve të praktikës me pagesë	 Pjesërisht

Inspektorat 3

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Zbatimi i kontratave të punës dhe respektimi i Ligjit të Punës për punëtorët në sektorin privat	 Pjesërisht



Komuna e Skënderajt

Kryetari i Komunë së Skënderajt gjatë fushatës zgjedhore në vitin 2021, ishte zotuar për adresimin e 19 problemeve të komunës në shtatë (7) fusha.



✓ Përbushur

42%

! Pjesërisht

53%

✗ Nuk ka progres

5%



Sociale 5

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ndërtimi i Qendrës rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara	✓ Përbushur
2	Përkrahje e personave me aftësi të kufizuara në ndërmarrësi	✓ Përbushur
3	Subvencionimi dhe mbështetja e bizneseve private, me theks të veçantë ato në pronësi të grave	✓ Përbushur
4	Ndarja e fondeve për subvencionim të ndërmarrësve	! Pjesërisht
5	Ndërtimi i qendrave rinore në bashkësi lokale	! Pjesërisht



Infrastrukturë 4




Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ndërtimi i pjerrinave për qasje në objektet publike	✓ Përbushur
2	Ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse në rrugët rurale	! Pjesërisht
3	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit	! Pjesërisht
4	Ofrimi i transportit publik ndërmjet zonave rurale dhe urbane	! Pjesërisht





Arsim 3

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ndërtimi i çerdheve publike	! Pjesërisht
2	Ndërtimi i trotuareve pranë shkollave	! Pjesërisht
2	Ofrimi i bursave për studentë të nivelit master dhe atyre që studiojnë jashtë vendit	! Pjesërisht


Ambient **3**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Pastrimi i shtratit të lumenjve	 Përbushur
2	Ofrimi i shërbimit për grumbullim të mbeturinave	 Pjesërisht
3	Krijimi i një organi komunal për mbikëqyrjen e hapësirave të gjelbra që dalin si rezultat i projekteve dhe donacioneve	 Pjesërisht

Administratë **2**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Digjitalizimi i shërbimeve komunale për qytetarët	 Përbushur
2	Krijimi i një komisioni/organi të veçantë për mbikëqyrjen e procesit të punësimit të mësimitdhënësve/eve në shkollat fillore dhe ato të mesme	 Nuk ka progres

Inspektorat **3**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Lirimi i trotuareve	 Përbushur

Sport **1**

Nr.	Zotimi	Statusi
1	Ndërtimi i poligoneve sportive në fshatra	 Përbushur

Në fushën sociale, Komuna e Skënderajt ka dhënë gjithsej pesë (5) zotime. Prej tyre, tri (3) janë përmbushur plotësisht, përfshirë ndërtimin e Qendrës rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara, përkrahjen e personave me aftësi të kufizuara në ndërmarrësi, dhe subvencionimin dhe mbështetjen e bizneseve private, me theks të veçantë ato në pronësi të grave. Ndërsa, dy (2) zotime të tjera: ndarja e fondeve për subvencionim të ndërmarrësve dhe ndërtimi i qendrave rinore në bashkësi lokale, janë realizuar pjesërisht.

Në fushën e infrastrukturës, janë dhënë gjithsej katër (4) zotime, prej të cilave një (1) është përmbushur plotësisht, ai i ndërtimit të pjerrinave për qasje në objektet publike. Tri (3) zotime të tjera siç janë ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse në rrugët rurale, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit, dhe ofrimi i transportit publik ndërmjet zonave rurale dhe urbane, janë realizuar pjesërisht.

Në fushën e arsimit, janë dhënë tri (3) zotime, ku të gjitha janë përmbushur pjesërisht. Këtu përfshihen ndërtimi i çerdheve publike, ndërtimi i trotuareve pranë shkollave dhe ofrimi i bursave për studentë të nivelit master dhe atyre që studiojnë jashtë vendit.

Në fushën e ambientit, janë dhënë gjithsej tri (3) zotime, prej të cilave një (1) është përmbushur plotësisht: pastrimi i shtratit të lumenjve. Ndërsa dy (2) zotimet tjera - ofrimi i shërbimit për grumbullimin e mbeturinave dhe formimi i një organi komunal për mbikëqyrjen e hapësirave të gjelbra që dalin si rezultat i projekteve dhe donacioneve, janë realizuar pjesërisht.

Në fushën e administratës, janë dhënë dy (2) zotime, nga të cilat një (1) është përmbushur plotësisht, që ka të bëjë me digjitalizimin e shërbimeve komunale për qytetarët. Ndërsa zotimi për formimin e një komisioni/organi të veçantë për mbikëqyrjen e procesit të punësimit të mësimitdhënësve/eve në shkollat fillore dhe ato të mesme, nuk ka shënuar progres.

Në fushën e inspektoriatit, është dhënë një (1) zotim, që ka të bëjë me lirin e trotuareve, i njëjti është përmbushur plotësisht.

Në fushën e sportit, është dhënë një (1) zotim, që ka të bëjë me ndërtimin e poligoneve sportive në fshatra, edhe ky zotim është përmbushur plotësisht.

